

Nr. regj. 18221/2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me procesmbajtësen Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Fatmir(Hyseni)Ademi, nga fshati Sibovc, Komuna e Podujevës, për kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe neni 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 31.07.2012 morri këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI: Fatmir(Hyseni)Ademi**, i lindur më 02.05.1971 në Sibovc Komuna e Podujevës, ku dhe jeton, ka kryer fakultetin e shkencave matematiko-natyrore, ushtrues i detyrës së Shefit të sektorit të ADN-së. i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

### **Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse si zyrtarë i lartë publik, i detyrës së Shefit të sektorit të ADN-së. nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31mars 2011, në Agjencinë kundër korrupsion, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 e neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, andaj i shqiptohet

## **D Ë N I M**

**Me gjobë në shumë prej 800(tetëqind)€**, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30(tridhjetë) ditësh**. Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga **5 €**, në afat dhe xhironlogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

## **A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsionit, në Prishtinë**, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën nr. 01-1834/2012 më datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit. Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se me marrjen e detyrës së Shefit të sektorit të ADN-së, më datë 19.12.2011, e ka deklaruar pasurinë, andaj ka menduar se nuk ka nevojë menjëherë përsëri ta deklaroi pasurinë duke pas parasysh se për një interval shumë të shkurtër kohor e ka deklaruar njëherë, poashtu thekson se nuk ka pas njohuri se duhet ta deklaronte pasurinë dhe në afatin ligjor deri më datën 31.03.2012 edhe pse ka marr një i-mall nga personi kontaktues duke konsideruar se brenda vitit një deklarim është i mjaftueshëm. Po ashtu deklaroi se nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme lidhur me ligjin në fuqi.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria dëgjoi përfaqësuesin e Agjencisë kundër Korrupsion Agron Behramin, i cili deklaroi se Fatmir Ademi ka pas një deklaram me marrjen e detyrës të cilin e ka bërë më datë 24.02.2012, pasi që ka kaluar një kohë e shkurtë prej deklaramit të pasurisë me marrjen e detyrës ne i kemi dërguar një i-mall pikës kontaktuese por i njëjti nuk e ka bërë deklaramin vjetorë të rregullt, pasi që ligji këtë e parasheh dhe e obligon përsëri ta deklarojnë.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimit të deklaramit të pandehurit, vlerësimit të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë pasi që më afatin e paraparë ligjor deri 31.03 2012, nuk ka bërë deklaramin e pasurisë, andaj e shpalli përgjegjës dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, duke konsideruar se i njëjti nuk i është shmangur deklaramit, por pasi që ka deklaram pasurin një muaj më herët e duke mos e njohur ligjin, ka bërë lëshim në ç rast nuk e deklaram pasurinë brenda afatit ligjor ashtu si që e parasheh ligji, duke e marr këtë si rrethanë lehtësuese aplikoi nenin 9 dhe i shqiptoi dënimin me gjobë, me bindje se edhe me këtë dënimi do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
**Nr. Regj. 18221/2012, më datë 31.07.2012**

Gjyqtaria  
Azra Cakoli



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.